



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 65 prot.

Himarë, më 26.06 . 2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI ,MBAJTUR NË MBLEDHJEN E MUAJT QERSHOR MË DATË
26.06.2024**

Sot më datë 26.06.2024,ora 10:30 zhvillohet mbledhja e këshillit Bashkiak Himarë ora 10:30 në sallën e Bashkisë me dyer të hapura.

Të ftuar nënkryetarët,drejtoritë kryetarët e fshatrave,kryetarët e njësive administrative.

Marrin pjesë këshilltarët.

Fuat Mati,Afrovita Dhimojani,Timoleo Gërdhuqi,Thëllëza Kokaveshi Aleks Llazari,Artan Bala,Artionil Shirokaj,Elisabeta Lamaj,Dhimitër Kapaj,Mirka Gjiçali,Nertila Husi,Loreta Isufi,Mklto Nika,Thodhori Foto,Maks Vlashi,Gjergji Iliadhi,Nikolin Laska,

Mungojnë : Silva Burbo,Miltiadh Prifti,Qirjako Mërkuri,Lenica Kocani.

Kryetari Këshillit hap mbledhjen.

Pika 1.

Vazhdojmë mbledhjen,Zonja sekretare cilat materiale janë shqyrtuar në komision ,na i lexo .

Sekretarja e këshillit: Kaluan ndihmat ekonomike,kalojë komisioni i Këshillit kulturor dhe artistikë,kaloi një shtesë për hyrjet dhe daljet e mjeteve lundruese gjatë sezonit turistik,shtesë te vendimi nr.1 i Këshillit bashkiak,u shqyrtuan dhe projektvendimi për reduktimin e zhurmave ,pra nuk u shqyrtuan ndryshimet buxhetore dhe komisioni i kryetarëve të fshatrave sepse mungonin anëtarët e komisionit.

Kryetari këshillit :- vazhdojmë me pikën 1.

Shqyrtimi i projektvendimit për ngritjen e këshillit kulturor dhe artistik në Bashkinë Himarë

Sqaron këshilltarët drejtori juridik.

Këshilltari Milto Nika:- Njësia administrative Lukovë pse nuk është e përfshirë në këtë komision?

Drejtori kulturës: sqaron,kemi kërkuar dhe kemi kontaktuar të ketë nga çdo njësi në komision por nuk kanë patur dëshirë të përfshihen.Edhe pse jam i ri në detyrë kemi kontaktuar dhe nuk kanë qënë të interesuar,ndoshta shprehje vullneti,ky është një proces që e përsëritim nëse doni mund ta ndryshojmë,nëse keni ndonjë emër konkret e çojmë.Kryetari këshillit:- pse

ndodh ky ndryshim emrash? Mesa di unë kanë ndërruar jetë dy prej tyre. Është procedurë që përsëritet çdo vit:- drejtori

Lëshilltari Timoleo Gërdhuqi:- duhet të keni bashkëpunim me anëtarët e këshillit për të zgjedhur emrat e anëtarëve të komisionit.Unë mendoj ta kalojmë këtë radhë.

Kryetari Këshillit :- ju si këshilltarë ju kërkoni informacion drejtorisë ky komision për çfarë shërben sepse ju anëtarët e këshillit nuk u ftuar në festën e fundit të Kuçit,çfarë programi keni si drejtori?

Drejtori kulturës:- muajin tjetër do t'ju sjellim një raport lidhur me këtë temë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :-juve si drejtori duhet të na vini në djeni për çdo aktivitet kulturor sepse keni miratuar një fond në buxhet për kulturën.

Drejtori kulturës: - ky material do të ishte miratuar që muajin e kaluar ,ne do tju sjellim çdo informacion që kërkoni.

Kryetari këshillit:- doni ta lëmë për muajin tjetër të marrim informacion të plotë?

Timoleo Gërdhuqi:- mendojë ta kalojmë.

Miratohet vendimi nr.17 ,mbi këshillin kulturor dhe artistik Bashkia Himarë.

Pika 2.

Për shqyrtimin e komisionit të përkohshëm të kryetarëve të fshatrave të Bashkisë Himarë nuk u shqyrtuan në komision dhe nuk e shqyrtoi as Këshilli.

Pika 3 dhe Pika 4 nuk u shqyrtuan pasi nuk u shqyrtuan nga komisioni,pra ndryshimet buxhetore dhe miratimi i ndryshimeve buxhetore nuk kaluan në mbledhje në shqyrtim.

Pika 5

Për miratimin e hartave të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë.

Sqaron drejtori zyrës juridike.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- në bazë të këtij plani a' është një monitorim?

Sqaron zyra juridike:- Po janë bërë 32 monitorime,ky monitorim është përqendruar më shumë në zonën e Bashkisë Himarë,ky plan do të përcaktoj më qartë zhurmat,nivelin e tyre gjatë natës ,që bizneset të mos shqetësojnë banorët. Do të jenë të afishuara ,do të çohen në fjeni çdo biznes në lidhje me këtë plan në mënyrë që të mos shqetësohen qytetarët nga zhurmat e larta .Për këtë kemi zhvilluar dëgjësë publike dhe vura re se pjesëmarrja nga banorët ishte e ulët ,banorët nuk janë të shqetësuar shumica mbi këtë çështje mesa kuptova.

Këshilltari Fuat Mati:- banorët duhet të lajmërohen sepse ajo nuk është dëgjësë publike.

Kryetari këshillit:- e hedhim në votim?

Miratohet vendimi nr.18,mbi planin e zhurmave në Bashkinë Himarë.

Pika 6

Shqyrtimi projektvendimit mbi “ shtesë në miratimin e planit të veprimit për menaxhimin e sezonit turistik 2024 dhe planet e veprimit përkatës.

Sqaron drejtori Sokrat Kreku:- është një vendim që e keni marrë më parë në muajin janar në këshill dhe ky është një shtesë që gabimisht ka ngelur jashtë për mjetet lundruese që hyjnë dhe dalin në Bashkinë Himarë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- Sa mjete hyjnë dhe dalin në Bashkinë Himarë?

Drejtori:- 20 hyjnë dhe dalin në Bashkinë tonë ,por i çojmë tani sepse kanë ngelur jashtë vendimit.

Kryetari Këshillit:- e hedhim në votim?

Miratohet vendimi nr.19,për shtesë vendimi për menaxhimin e planit të sezonit turistik 2024 dhe planet e veprimit përkatës Bashkia Himarë.

Pika 7.

Miratohet vendimi nr.20 mbi ndihmën ekonomike për muajin 1- 30 prill,2024,nga fondi 6% bashkia Himarë.

Pika 8

Miratohet vendimi nr.21 mbi ndihmën ekonomike për muajin 1 – 31 maj,2024 nga fondi 6% ,Bashkia Himarë.

Të ndryshme.

Shqyrtohet kërkesa e Z.Aleks Bala ,për çuarjen e pllake memorjale për të përndjekurit politik të regjimit ,në sheshin e restorantit “ Pizza” kërkesë nga Kryetari shoqatës antikomuniste.

I kalon zyrës juridike për trajtim të mëtejshëm.

Shqyrtohet kërkesa e Z. Ndreko Manol Dhimjaku datë 05.06.2024

Në lidhje me pronësinë ,i kalin për shqyrtim drejtorisë përkatëse pasi nuk është kopetencë e këshillit.

Shqyrtohet kërkesa e Z.Theofan Ilia Menika. I kalon për trajtim drejtorisë përkatëse ,nuk është kopetencë e këshillit.

Shqyrtohet kërkesa e Z. Dhimitraq Bollano e cila i kalon për shqyrtim drejtorisë përkatëse nëpërmjet sekretarisë së Këshillit.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen.

Sekretari

Elena Memtushaj

Adresa: Krr. "25 Marsi" nr.7, Sullc, Himarë; e-mail: info@himara.gov.al ;WEB:www.himara.gov.al

3 of 3